REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. ____ prot. Tiranë, më ___ . ___ . 2022

Lënda: Mbi raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, për periudhën janar - prill 2022

KOMISIONIT PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË DREJTAT E NJERIUT

Tiranë

Të nderuar anëtarë,

Në zbatim të pikave 2 dhe 3, të nenit 19, të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", po ju parashtrojmë dokumentin e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, për periudhën janar - prill 2022, miratuar me vendimin nr. 06 prot, datë 03.06.2022, të Mbledhjes së Grupit për Menaxhimin Strategjik.

Në zbatim të kërkesave ligjore, bazuar në nenin 65 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 22, datë 17.11.2016, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore", ligjit nr. 115, datë 25.11.2021, "Për buxhetin e vitit 2022", Aktit Normativ nr. 3, datë 12.03.2022, "Për disa ndryshime në ligjin nr. 115, datë 25.11.2021,"Për buxhetin e vitit 2022", udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka përgatitur Raportin e Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit për periudhën janar - prill 2022, sipas kësaj shkrese dhe dokumenteve bashkëlidhur.

Monitorimi është një proces vlerësimi performance, i cili realizohet nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë me ata të planifikuar. Në kuadër të menaxhimit financiar, monitorimi i kushtohet një vëmendje e veçantë si një nga 5 komponentët shumë të rëndësishëm të kontrollit të brendshëm. Monitorimi për veprimtarinë institucionale të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për 4- mujorin e parë të vitit 2022, është kryer në kuadër të një analize krahasimore plan-fakt sa i përket produkteve të përcaktuar dhe zërave të shpenzimeve, dhe planifikimit të buxhetit në Projekt Buxhetin Afatmesëm (2022-2025).

Në kërkesat buxhetore për vitin 2022, Kolegji i Posaçëm të Apelimit, ka përcaktuar si produkt kryesor në realizimin e objektivit, "Çështje të ankimuara/shqyrtuara" me një plan vjetor në masën 70 çështje. Gjatë periudhën janar - prill 2022, Kolegji ka marrë në shqyrtim 22 çështje me një realizim prej 31.4 %.

Fondet buxhetore të akorduara nga buxheti i shtetit për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit në zbatim të ligjit nr. 115, datë 25.11.2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar

me Aktin Normativ nr. 3, datë 12.03.2022, janë përcaktuar në vlerën 194,840 mijë lekë. Plani për periudhën 4/mujore është ***68.324 mijë lekë*** dhe realizimi ***48.352 mijë*** lekë ose ***70.8 %***.

Shpenzimet buxhetore sipas artikujve kryesore, paraqiten në tabelën në vijim.

000/lekë

Llogaria ekonomike	Emertimi	Plani vjetor (i rishikuar)	Plani 4-mujor (i rishikuar)	Realizimi 4-mujor	% realizimit
6000000	Paga	157.658	55.930	42.958	76.8%
6010000	Kontribute për sigurimet shoqërore, shëndetsore	13.318	4.730	3.737	79.0%
6020000	Mallra dhe shërbime	20.160	3.960	1.446	36.5%
6060000	Trans per Buxh. Fam. & Individ	1.704	1.704	211	12.4%
2310000	Investime Kapitale	2,000	2.000	0	0.0%
	Totali	**194.840**	**68.324**	**48.352**	**70.8%**

I - <u>Shpenzimet për paga (llogaria ekonomike 600)</u>

Buxheti i rishikuar për vitin 2022 në paga është ***157.6 milionë lekë*** dhe përbën 80.1 % të buxhetit total vjetor. Buxheti i detajuar në paga, për periudhën janar- prill 2022, është ***55.9 milionë*** lekë dhe realizimi ***42.9 milionë*** lekë ose 76.8 %.

Kjo vlerë përfshin pagat e punonjësve të strukturës organike prej 49 (dyzet e nëntë) punonjës, të miratuar me vendimin e Kuvendit nr. 82/2020, "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit" dhe pagat për 6 (katër) punonjës me kontratë të përkohshme përcaktuar në VKM-në nr. 35, datë 19.01.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2022.

Gjithashtu me buxhetin e detajuar për këtë periudhë është kryer pagesa e efektit prapaveprues për periudhën qershor 2017- nëntor 2018, për gjyqtarët dhe këshilltarët e Njësisë së Shërbimit Ligjor që janë në marrëdhënie pune me Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, në shumën 5.7 milion lekë. Me shkresën nr. 264 prot., datë 14.02.2022, i jemi drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, duke kërkuar ndryshimet e nevojshme në listë pagesat e deklaruara në sistemin tatimor online.

Niveli i realizimit të këtij zëri të shpenzimeve është ndikuar nga fakti që procedurat e rekrutimit për 3(tre) këshilltarë të Njësisë së Shërbimit Ligjor, nuk kanë përfunduar gjatë kësaj periudhe, si dhe nuk është përdorur fondi i detajuar për pagesën me një pagë mujore, si vështirësi për këshilltarët e Njësisë së Shërbimit Ligjor. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe nuk janë plotësuar vendet vakante për pozicionet specialiste financë/buxheti dhe specialiste sekretarie gjyqësore, procedurat e rekrutimit për të cilat nuk kanë përfunduar gjatë kësaj periudhe.

II - <u>Shpenzimet për sigurime shoqërore (llogaria ekonomike 601)</u>

Buxheti i rishikuar për vitin 2022 në sigurime shoqërore dhe shëndetësore është ***13.3 milionë lekë*** dhe përbën 6.8 % të buxhetit total vjetor. Buxheti i detajuar në zërin sigurime shoqërore, për periudhën janar- prill 2022, është ***4.7 milionë*** lekë dhe realizimi ***3.7 milionë*** lekë ose 79 %. Fondi për sigurimin është i lidhur me marrëdhëniet e punësimit, dhe në

përpjesëtim të drejtë me shpenzimet për paga, si rrjedhojë argumentet e nivelit të realizimit të fondit të pagave vlejnë dhe për këtë zë.

III - Shpenzimet për blerje mallra dhe shërbime (llogaria ekonomike 602)

Në këtë zë përfshihen një gamë e gjerë materialesh dhe shërbimesh të domosdoshme për mbështetjen e veprimtarisë institucionale. Buxheti i miratuar në shpenzime operative për vitin 2022, pas Aktit Normativ nr. 3, datë 12.03.2022 është ***21.6 milionë lekë***, dhe përbën 11% të buxhetit total vjetor.

Buxheti i rishikuar pas transferimit të fondit në vlerë 1,440 mijë lekë nga artikulli 602 ne artikullin 606, për mbulimin e shpenzimeve të telefonisë celulare për gjyqtarët e Kolegjit është ***20.2 milion lekë***.

Buxheti i detajuar në shpenzime operative, për periudhën janar- prill 2022, është ***4 milionë*** lekë dhe realizimi ***1.4 milionë*** lekë ose 36.5 %.

Në mënyrë të detajuar shpenzimet për mallra dhe shërbime paraqiten në tabelën në vijim:

MALLRA DHE SHËRBIME TË TJERA	**Realizimi viti 2022 (në lekë)**
Shpenzime për uniforma	**100.000**
Shpenzime për energji elektrike	**493.548**
Shpenzime për furnizimin me ujë	**14.424**
Shpenzime për blerje ujë të pijshëm për personelin dhe seancat gjyqësore	**10.800**
Shërbime telefonie celulare	**204.835**
Shërbime telefonie fikse	**9.584**
Posta dhe shërbim korrieri + abonim në shtypin e shkruar	**35.775**
Shpenzime publikimi në shtyp për pozicionet vakante në institucion	**230.400**
Shpenzime për sigurimin e jetës, shëndetit dhe pronës	**146.100**
Shërbime transporti (parkim për automjetin e institucionit + lavash + mirëmbajtje)	**200.400**
TOTALI	**1.445.866**

Gjatë periudhës janar - prill 2022, janë shlyer detyrimet lidhur më shpenzimet për energji elektrike, furnizim me ujë, shpenzime postare (postim dokumentacioni, abonim në shtypin e shkruar), telefoni fikse, si dhe publikime në media të vendeve të shpallura vakante në institucion, për një vlerë totale 794.531 lekë.

Janë kryer shpenzime për prodhimin e togave gjyqësore për gjyqtarët e Kolegjit, si dhe për prodhimin e maskave për mbrojtje nga Covid -19, me logon e institucionit në vlerën 100.000 lekë.

Janë kryer shpenzime për telefoninë celulare ku përfshihen prokurimi i shërbimit për Kryetaren e Kolegjit, këshilltarët e Njësisë së Shërbimit Ligjor dhe drejtuesve të administratës si dhe kompensimi i gjyqtarëve, sipas kuotës mujore, përcaktuar me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve nr. 28, datë 21.12.2020, ndryshuar me vendimin nr. 23, datë 05.02.2021, në vlerën 204.835 lekë.

Janë kryer shpenzime për automjetin e institucionit duke përfshirë pastrimin dhe vend parkimin me vlerë totale 200.400 lekë.

Në realizimin e kësaj periudhe janë përfshirë shpenzime që i përkasin kontratave në vazhdim, për sigurimin e jetës dhe shëndetit, për punonjësit e rinj, për një vlerë totale 146.100 lekë.

Janë plotësuar nevojat e institucionit për materiale dhe shërbime të nevojshme gjatë aktivitetit të përditshëm të institucionit ku përfshihen shpenzime për kancelari, letër A4,

materiale pastrimi dhe dezinfektimi, në vlerën 756.932 lekë, por që nuk janë përfshirë në tabelën e mësipërme, pasi janë likuiduar në muajin maj 2022.

Gjithashtu në nivelin e ulët të realizimit për kategorinë mallra e shërbime, për këtë periudhë, ka ndikuar edhe fakti që janë ende në proçes procedurat e prokurimit për blerjen e karburantit për automjetin e institucionit si dhe furnizimi me tonera për institucionin si pjesë e marrëveshjes kuadër të nënshkruar në vitin 2020.

IV - Shpenzimet për Trans per Buxh. Fam. & Individ (llogaria ekonomike 606)

Buxheti i detajuar në këtë zë është në vlerën 1,704 mijë lekë dhe realizimi 210 mijë lekë ose 12.4%.

Në këtë grup përfshihet fondi i veçantë në vlerë 264 mijë lekë miratuar me ligjin nr. 115, datë 25.11.2021, "Për buxhetin e vitit 2022" si dhe fondi në vlerë 1,440 mijë lekë për mbulimin e shpenzimeve të telefonisë celulare për gjyqtarët e Kolegjit, transferuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr. 299 prot., datë 18.02.2022, nga artikulli 602 "Shpenzimet për blerje mallra dhe shërbime" ne artikullin 606.

Gjatë kësaj periudhe është kryer pagesa prej një page mujore, në vlerë 50.715 lekë, me rastin e daljes në pension të ish- punonjësit të magazinës, sipas përcaktimeve në VKM nr. 929, datë 17.11.2020 " Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë", i ndryshuar si dhe rimbursimi i shpenzimeve telefonike të gjyqtarëve sipas përcaktimit në VKM nr. 673, datë 02.09.2020 "Për pajisjen me numër telefoni celular të funksionarëve publik", të ndryshuar, si dhe vendimit nr. 28, datë 21.12.2020, të Mbledhjes së Gjyqtarëve.

V. Investime kapitale (431)

Buxheti i miratuar me ligj për vitin 2022 në investime është ***2 milionë lekë*** dhe përbën 1 % të buxhetit total vjetor. Buxheti i detajuar në zërin investime, për periudhën janar- prill 2022, është ***2 milionë*** lekë dhe realizimi ***0 (zero)***lekë ose 0 %.

Këto fonde janë parashikuar për plotësimin e nevojave për punonjësit shtesë të kërkuar në strukturën organike për vitin 2022, me pajisje elektronike (kompjuter, laptop printer, ups, etj) në vlerën 1.2 milion lekë dhe pajisje dhe mobilje zyre në vlerën 800 mijë lekë.

Me daljen e Vendimit të Kuvendit nr. 35/2022, "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit", sipas të cilit është miratuar kërkesa e Kolegjit për një shtesë prej 8(tetë) punonjësish në strukturën organike si dhe përfundimin e procesit të kontraktimit të ambienteve shtesë nëpërmjet qiramarrjes për nevojat e Kolegjit, do të vijohet me procedurat e prokurimit sipas parashikimeve të mësipërme.

Sa më sipër, bashkëlidhur do të gjeni formatet standarde për raportimin e monitorimit të zbatimit të buxhetit për periudhën janar-prill 2022, të miratuara nga Grupi i Menaxhimit Strategjik i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Duke ju falënderuar,